



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 61/12
Prishtinë, më 25.04.2012, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
IMBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Duda Balje, Xhevdet Neziraj, Muhamet Mustafa dhe Albana Fetoshi.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini dhe Dashuriye Canolli, Ardita Fejza (praktikante) dhe Kushtrim Aliu (praktikant).

Gjithashtu ishin të pranishëm: Scott Bowen dhe Bardha Keqa nga AKP, Përparim Kabashi dhe Ejup Hasolli nga ZRRE, Halit Gara dhe Enis Berisha nga ARRH, Alexander Beetz, Rejhane Zylfijaj nga GIZ, monitorues nga OSCE, KDI.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të komisionit në datat 04.04.2012 dhe 11.04.2012 dhe 17.04.2011**
3. **Raportim nga Ministri i Financave lidhur me zbatimin e Ligjit Nr. 03/ L-196 për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit;**
4. **Shqyrtimi i Raportit Financiar të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2011;**
5. **Shqyrtimi i Raportit financiar të Zyrës Rregullative të Energjisë për vitin 2011;**
6. **Shqyrtimi i Raportit Financiar të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2011;**
7. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, konstatoi se rendi i ditës miratohet unanimisht.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të komisionit në datat 04.04.2012 dhe 11.04.2012 dhe 17.04.2011

Kryetarja, konstatoi se procesverbalet e datave të mësipërme miratohen unanimisht.

3. Raportim nga Ministri i Financave lidhur me zbatimin e Ligjit Nr. 03/ L-196 për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit

Kryetarja, në planin vjetor të punës është paraparë monitorimi i këtij ligji. Për këtë qëllim e kemi ftuar Ministrin që për pjesën kompetent që është Ministria, në pika të shkurtra të na jap informata cili është opinionin e Ministrit rreth zbatueshmërisë së këtij ligji dhe a kanë pasur vështirësi që nga miratimi i këtij ligji deri më sot sepse ka qenë një ligj i ndishëm dhe problematik.

Bedri Hamza, theksoi se me aprovimin e këtij ligji ne zhvilluam një bazë ligjore të avancuar në këtë fushë. Në përputhje me kërkesat që dalin nga ligji, themeluan Njësine e Intelgjencës Financiare. Duke pasur parasysh se me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/2 është themeluar Qendra e Intelgjencës Financiare e cila ishte nën kompetencat e UNMIK-ut dhe më pas e transferuar në EULEX, në pjesën e dytë të viti 2010 është nënshkruar një memorandum i mirëkuptimit nga ish shefi i EULEX-it dhe ish Ministri i Ekonomise dhe Financave për tranzicion të QIF-së nga EULEX-i në NJIF-në në Ministri të Financave. Në ligjin për buxhet për vitin 2012 është rritur numri i stafit të Njesisë së Intelgjencës Financiare për 5 zyrtar që do të trajnohen nga ekspertët ndërkombëtarë të EULEX-it dhe hartuan planin e tranzicionit, dhe në fund të prillit është paraparë që të fillojnë punën kandidatët e zgjedhur. Në muajin maj është paraparë zhvillimi i trajnimeve. Më 1 qershor jemi pajtuar të jetë data e ceremonisë për pranim dorëzim të kompetencave nga Qendra e Intelgjencës Financiare në njësine e Intelgjencës Financiare. Në mbledhjen e parë të bordit të themeluar, në fund të vitit 2010 kemi emëruar drejtorin vendor të Njesisë së Intelgjencës Financiare. Drejtori vendor është duke bashkëpunuar me drejtorin ndërkombëtarë deri në datën finale të tranzicionit.

Xhevdet Neziraj, n theksoi se ne jemi të interesuar të kemi takime me njerëz të caktuar të shohim ku janë problemet për zbatimin e këtij ligji, por unë po shoh që ende nuk qenka kompletuar kryesisht njësia e cila merret me këtë problematikë mirëpo, është mirë këtë material ta leni në sekretari ta kenë të gjithë anëtarët e grupit punues dhe ne do të mirremi vesh që me njerëz kompetent të takohemi. Meqenë se ky ligj do të pësoj ndryshime dhe para se të pësoj ndryshime të dijmë se ku janë të metat e ligjit, ku nuk po zbatohet dhe të nxjerrim rekomandime konkrete që mund të merren parasysh me rastin e ndryshimit të tij.

Kryetarja, kemi qenë të interesuar deri ku kemi arritur në bartjen e këtyre kompetencave sepse e kuptojmë që ka qenë një natyrë pak specifike dhe vështirësitë janë evidente. Në raportin e progresit kemi pasur shumë çështje që kanë të bëjnë me këtë ligj, prandaj ne si komision në bazë të monitorimit të shohim si është situata në terren dhe të jemi më afër problemit. Janë edhe 3 ose 4 nene që duhen të implementojn direkt Prokuroria, është mirë të shikohet edhe aty sa janë të zbatueshme ato nene aty dhe të shohim edhe në takime të mëtutjeshme se ku është problemi. Në qoftë se ska nevojë të ndryshohet është në rregull, ata i sjellin plotësim-ndryshimet dhe ne i kthejmë mbrapa dhe themi se ska nevojë të amendamentohen. Nëse është e nevojshme të amendamentohen diku ne ta shohim gjendjen në praktikë se si është.

Latif Gashi, theksoi se ne kemi pasur shumë probleme me këtë ligj sepse është ligj i sponzoruar prej evropianëve, departamenti i thesarit amerikan dhe është e nevojshme të bëhet një monitorim për të parë nivelin e zbatimit dhe problemet në praktikë.

4. Shqyrtimi i Raportit Financiar të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2011

Kryetarja, Agjencisë Kosovare të Pronës ka sjellur një Raport ku shifet se gjatë këtij viti ka shfrytëzuar buxhetin e planifikuar 90%, dhe ka pasur një pjesë të buxhetit nga donatorët që e ka shfrytëzuar për kryerjen

e nevojave të veta. Për paga dhe Mëditje është shpenzuar 89%, Mallra dhe Shërbime 92%, Shpenzime Kapitale 83%.

Scott Bowen, prezantoi aktivitet e AKP-së në trajtimin e kërkesave dhe zgjidhjen e tyre, ku numri i kërkesave të vendosura deri më 31 dhjetor 2011, është 230.647, dhe 13 mijë e 381 kërkesa më shumë se numri i raportuar në dhjetor 2010. Numri i përgjithshëm i vendimeve të implementuara është 7.927. AKP-ja vazhdon të ketë probleme shumë të mëdha për zbatimin e vendimeve në pjesën veriore të Mitrovicës. Përveç kësaj është problem edhe riezurpimi i pronave pasi që kryhet dëbimi nga Agjencia e Pronës që është shkelje e kodit penal të Kosovës dhe kërkon mbështetjen e forcave të Policisë së Kosovës. Implementimi i skemës së kompenzimit që AKP e ka trashëguar nga drejtoria për çështje pronësore nuk është përfunduar.

Bardha Keqa, raporti se përvetësimet buxhetore të AKP-së për vitin 2011 kanë qenë 2.270.624 euro ose 56% të buxhetit total të AKP-së, donacionet në total kanë qenë 1.532.000 euro, kurse të hyrat vetanake në vlerë prej 48.000 një pjesë e të cilave është bartur nga viti paraprak. Shpenzimet totale nga buxheti i Kosovës për vitin 2011 ka qenë 1,817.609 euro ne përqindje 89%. Nga totali i donatorëve në vlerë prej 2 milion euro, 1.5 milion euro janë alokuar, pasi pjesa tjetër ka paraqitur donacionin norvegjez të dedikuar për vitin 2012 në përqindje 99.33%. Diferencat e implementimit të buxhetit nëpër vija për fondet e pa shpenzuar janë: Paga dhe Mëditje mbetja prej 108.000 euro, për të kompenzuar shumën ekuivalente të donatorëve për t'u përdorur për pagat e personelit vendor duke e rritur përqindjen e Buxhetit të Kosovës për buxhetin e AKP-së dhe duke zvogëluar përqindjen e fondeve të donatorëve e cila nuk është lejuar për shfrytëzim sipas Komisionit për Buxhet dhe Financa. Në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve varianca përbëhet prej 380,108 euro e cila nuk është alokuar në kuadër të vendimit të Qeverisë së Kosovës dhe si e tillë nuk ka qenë në dispozicion për t'u përdorur. Diferenca prej 22.000 euro është si rezultat i mbylljes së vitit fiskal dhe pamundësisë së finalizimit të disa furnizimeve të parapara. Në Investimet Kapitale kemi një shumë prej 36.000 euro e cila nuk është realizuar për shkak se furnizimi i pjesëve të dy serverëve nuk ka mundur të finalizohet.

Kryetarja, pyeti qfarë keni kuptuar me buxhetin e rishikuar, ku rishikimin e buxhetit e bënë Qeveria por njëkohësisht Kuvendi dhe ne e miratojmë. Çështja tjetër që po më intereson është paga për stafin lokal jashtë Kosove, për cilin stafi është fjala? Në raportin e juaj nuk e keni sjell të detalizuar shpenzimet për mallra dhe shërbime dmth si ka shkuar rrjedha e shpenzimeve në krahasim me ata të planifikuar që është një defekt i të gjitha agjencioneve të pavarura. Po ashtu tek veturat janë ndarë 48,000 euro të shpenzuara nuk po vërehen sa janë shpenzuar.

Latif Gashi, te shpenzimet kapitale dmth kemi një raportim të përgjysmuar, ku keni bërë përshkrim e shpenzimeve kapitale, për vetura thuhet 100 mijë euro janë shpenzuar nuk precizohet së për qfarë lloj veturash, sa vetura, gjithashtu mungojnë sqarimet për paisje për IT.

Hasime Krasniqi, theksoi se duke u bazuar në këto shifra që janë ofruar nuk mundemi të bëjmë vlerësimin se a është bërë një shpenzim i arsyeshëm apo jo. Është ofruar një raport vetëm në vija të trasha pa i ditur specifikat e veçanta apo nënkategoritë e këtyre shpenzimeve. Kisha propozuar që të na sjellin një raport më të detajuar financiar dhe mos të shkojmë në Kuvend më këtë përmbledhje.

Naser Osmani, propozoj që në mbledhjen e radhës të komisionit ta shqyrtojmë edhe një herë Raportin financiar të AKP-së dhe brenda javës së ardhshme ju na dërgoni edhe këto tabelat që janë kërkuar.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri, nxori këtë

PËRFUNDIM

Shtyhet shqyrtimi i raportit financiar të AKP-së për vitin 2011, për mbledhjen e radhës së Komisioni. Kërkohej që AKP të dorëzojë një raport plotësues të detalizuar financiar.

5. Shqyrtimi i Raportit financiar të Zyrës Rregullative të Energjisë për vitin 2011

Kryetarja, nga të dhënat shifet që Zyra e Rregullatorit të Energjisë e ka shpenzuar buxhetin diku 91.55%. Ne shqyrtojmë vetëm raportin financiar dmth rrjedhën e shpenzimeve në krahasim me ato çka është planifikuar gjatë vitit 2011.

Përparim Kabashi, njoftoi se ZRRE financohet nga të hyrat vetanake të cilat janë të përcaktuara në bazë të ligjit për rregullatorin për energji, përkatësisht taksave të cilat lidhen nga kompanitë e licencuara nga zyra e rregullatorit. Kuvendi i Kosovës në Ligjin për Buxhetin për vitin 2011 ka miratuar buxhetin e ZRRE-së në vlerë prej 675,000 euro bordi i zyrës së rregullatorit më qellim të harmonizimit të hyrave të grumbulluara nga të licencuarit ka marrë vendim që të licencuarit të lirohen në periudhën mars-tetor të vitit 2011, shuma totale e cila është diku mbi 800,000 euro. Gjithashtu ka qenë edhe një reduktim i të hyrave të lejuara të vendimit të Qeverisë së Kosovës në vlerë prej 15.000 euro. Në mënyrë tabelare janë paraqitur edhe shpenzimet sipas këtyre katër kategorive ekonomike. Ndryshimi në mes shpenzimeve të cilat i ka realizuar ZRRE për vitin 2011 është në shumën 600.400 euro dhe të hyrat të cilat i ka realizuar mbetet që për vitin 2012 të bartën 100.900 euro si të hyrat e dedikuara.

Muhamet Mustafa, më intereson shpjegimi lidhur me lirimin e pagesës së mjeteve prej 800 mijë euro, ndaj të licencuarve?

Përparim Kabashi, shpjegoi se bazuar në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë shuma e cila sigurohet prej taksave duhet të jetë që të mbulojë funksionimin e zyrës së rregullatorit, këto të hyra janë të dedikuara, prandaj bordi i zyrës së rregullatorit që të bëjë baraspeshimin e buxhetit që është përcaktuar prej Kuvendit të Kosovës, me të hyrat që i ka realizuar gjatë vitit 2011, ka marrë vendim që të lirohen për këtë periudhë taksat të cilat i merr zyra e rregullatorit paguar prej konsumatorëve.

Latif Gashi, pyeti a keni bërë përpjekje ndonjëherë të gjeni ndonjë objekt zyrtar që t'i ikni qerasë edhe të ruani buxhetin? Edhe shpenzimet e telefonisë mobile dhe shpenzimet fikse konsiderohen të larta, kur dihet se ju nuk keni një numër të madh të punëtorëve dhe pyetja është a u paguhen që gjithë punëtorëve shpenzimet e telefonit? Sa është humbja e shpenzimeve komerciale dhe sa është ajo teknike?

Përparim Kabashi, njoftoi se humbjet e përgjithshme të realizuara për vitin 2011 janë 38% edhe teknike edhe komerciale. Humbjet teknike të vlerësuara sepse saktë nuk mund dihet është diku rreth 17% ndërsa pjesa tjetër është humbje komerciale. Qiraja për ndërtesë ne kemi pas sipas rregullave qdo dy vite është shpall tenderi dhe në objektin të cilin jemi ka qenë më i liri ku është vlerësuar prej komisionit vlerësues. Për telefonat mobil, bordi është prej pesë anëtarve dhe i kemi pesë departamente të cilet mbulohen me shumën e caktuar dhe tre eksperta.

Latif Gashi, pyeti qfarë rekomandime keni dhënë për t'u zvogëluar humbjet komerciale dhe teknike?

Përparim Kabashi, zyra e rregullatorit nuk ka kompetencë për më marrë masa për të matur performancën e menagjmentit të KEK-ut e as të asnjë kompanie tjetër në sektorin e energjisë. Ndërsa masat ne i marrim nëse ata i bëjnë shkeljen që lidhen me legjislacionin sekondar të zyrës, nëse nuk e respektojnë rregullën për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji elektrike që ndërlidhet edhe me konsumatorët edhe me të licencuarit.

Salih Asllanaj, sa janë reale kërkesat e KEK-ut për ngritje të çmimit, dhe sa kishte më qenë e arsyeshme ajo ngritje, dhe a ka mundësi që KEK-un më bërë më efikas që ato humbje teknike dhe komerciale pak më shumë më i reduktua?

Përparim Kabashi, Bordi ka marrë vendim që për gjashtë vitet e ardhshme humbjet e përgjithshme teknike dhe komerciale të zvogëlohen në tri vitet e para 3%, secilin vit nga 3% dhe në tri vitet e dyta nga 2.5%. Ne kemi thenë që kompania nuk do t'i zvogëlojë humbjet ne nuk do ti pranojmë ato sepse humbjet janë mjete. Ne kemi marrë edhe një vendim tjetër që lidhet për rikthimin e investimeve që i themi në kostoja mesatare e kthimit të kapitalit që ndërlidhen me kompanitë më investimet e tyre.

Latif Gashi, dmth që 3% theksuat që janë zvogëluar në 6 milion euro humbje?

Përparim Hasani, mendoj që duhet të ndahen në dy aspekte humbjet teknike për shkak të proceseve fizike që kalon energjia elektrike prej gjenerimit deri të konsumatori janë të pranueshme. Humbjet komerciale janë vjedhjet e energjisë elektrike, kyçjet ilegale mirëpo ato lidhen më performancën e menagjmentit të licencuarave, ne nuk kemi përgjegjësi për më marr performancën e tyre, ne japim raportin tonë.

Kryetarja, për shërbimet e ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse sa ka qenë shuma e planifikuar e mjeteve?

Ejup Hasolli, njoftoi se gjatë përgatitjes së buxhetit 2011, ne kërkesën drejtuar Ministrisë së Financave në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ka qenë 300.000 euro dhe ajo është zbritur në 250.000 euro, dhe zbritja pikërisht ka ndodhur në këtë kategori.

Kryetarja, në raport shifen shpenzimet e detalizuara, por mungon kolona e planifikimit, për çka është të buxhetit për kategoritë dhe nënkategoritë ekonomike, krahasimi i tyre dhe krahasimi me vitin e kaluar. Ne do të mund të miratonim raportin me kusht që të dërgohet raporti shtesë financiar me kolonën e planifikimit, që do të shqyrtohet dhe bashkangjitet rekomandimit të komisionit në seancë plenare.

Latif Gashi, propozojë që të mos aprovohet ky raport, por t'i sjellin edhe raportet tjera detale e pastaj ta shqyrtojmë në mbledhjen e radhës.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni me dhjetë vota Për (Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Muhamet Mustafa, Albana Fetoshi, Duda Balje dhe Xhevdet Neziraj), një Kundër (Sali Asllanaj), asnjë Abstenim, nxori këtë

PËRFUNDIM

Shtyhet shqyrtimi i raporti financiar të ZRRE-së për vitin 2011, për mbledhjen e radhës së Komisioni. Kërkohej që ZRRE të dorëzojë një raport plotësues financiar, në të cilën prezantohen planifikimi i buxhetit dhe realizimi i shpenzimeve, krahasimi në mes tyre, dhe shprehja e tyre në përqindje.

6. Shqyrtimi i Raportit Financiar të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2011

Halit Gara, ARRH-ja për vitin 2011 duke përfshirë të gjitha kategoritë ka pasur një buxhet prej 161.505 euro, këtë buxhet e kemi shpenzuar duke i respektuar afatet ligjore, standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik, ligjit për menaxhimin e financave publik dhe ligjin e hekurudhave.

Enis Berisha, raporti për shpenzimet buxhetore siç ishin prezantuar edhe në raport. Për Paga dhe Mëditje nuk na kanë mjaftuar mjetet mirëpo me vendim të Qeverisë për ndarjen e 2.030 euro jemi barazuar në fund të vitit me 99.99% total. Buxheti në dispozicion për mallra dhe shërbime ka qenë 73.522 euro dhe prapë me një vendim të Qeverisë na u është reduktuar buxheti për 4.561 euro.

Latif Gashi: A keni bërë përpjekje ndonjëherë të keni qasje në komunat si Leposaviq, Zubinpotok dhe pjesët tjera për të kryer detyrat e juaja ligjore?

Halit Gara, në pyetjen e parafolësit, njoftoi se nuk kanë pasur kapacitete e duhura për t'i kryer aktivitetet ligjore që na takojnë.

Kryetarja, a mund të na jepni një sqarim sa i përket asaj që i keni pasur të planifikuar 12 punëtorë, aktualisht janë 9 punëtorë, shpenzimet të Pagat dhe Mëditjet janë 100%?

Halit Gara, 12 punëtorë janë për vitin 2012 tash raporti është 2011 i kemi vetëm 9 pozita të lejuara për këtë vit jemi më mirë në kuptimin e mbulimit të 3 departamenteve kemi edhe një anë negative sepse na mungon niveli mbështetës. Kemi vetëm kryesuesit e departamenteve siç e parasheh ligji dhe nuk kemi personelin mbështetës.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri, nxori këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të miratojë raportin financiar të ARRH-së për vitin 2011.

7. Të ndryshme.

7.1. Kryetarja, njoftoi se raportet e komisionit për projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat personale, projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave, projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave në Kosovë dhe projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në vlerën e shtuar, janë shqyrtuar nga komisionet tjera dhe nuk kanë ndonjë vërejtje dhe janë përgaditur raportet finale të komisionit për miratim në seancë plenare. Sa i përket projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave në Kosovë, në raportin final është bërë një rregullim në nenin 4, i cili është ndarë në katër nene, për shkak se me projektligj me këtë nen janë rregulluar katër nene, dhe ky ndryshim është në pajtim me teknikën dhe standardizimin juridik dhe janë përfshirë të gjitha ndryshimet që janë miratuar në komision. Për më tepër raporti final i'u është shpërndarë të gjithëve dhe mund t'i shikoni.

Mbledhja përfundoi: 12:40

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjona